



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
KESHILLI**

Nr. 1105/20 prot

Koplik më: ///05/2020

V E N D I M

Nr 30 datë 30 / 04 / 2020

PËR

”Miratimin e kërkesës së Bashkisë Malësi e Madhe së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor përkatës, të z. Fatmir Peraj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga mot i keq i rene ne banesen e ketij shtetasi, si dhe për akordimin e ndihmës financiare për familjen e këtij shtetasi nga buxheti i bashkisë dhe nga buxheti i vitit 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, programi për “emergjencat civile”

Baza Ligjore

Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar

Ligji për Prefektin e Qarkut

Ligji Nr 45/2019 Për mbrojtjen civile

VKM nr.329 datë 16/5/2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”

VKM, Nr.965, datë 02/12/2015 „Për bashkëpunimin ndërinstitucional të strukturave të drejtimit në rastet e emergjencave civile dhe krizave“.

Vendosi;

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Malësi e Madhe për mbështetje financiare të familjes së shtetasit Fatmir Peraj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga mot i keq i rene ne banesen e ketij shtetasi.
2. Të miratojë dokumentacionin tekniko - ligjor përkatës të hartuar nga Bashkia Malësi e Madhe për dëmtimin e shtëpisë.
3. T’i akordojë familjes së shtetasit Fatmir Peraj, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga mot i keq i rene ne banesen e ketij shtetasi, dhënien e ndihmës së menjëherëshme/emergjente financiare në vleren/shumen 100.000 (njqind mijë) lekë nga fondi rezervë i buxhetit të Bashkisë Malësi e Madhe i vitit 2020.





4. T'i paraqesë dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës të familjes së shtetasit **Fatmir Peraj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga mot i keq i rene ne banesen e ketij shtetasi dhe t'i propozojë/kërkojë mbështetje Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile (DPEC), në Ministrinë e Mbrojtjes për akordimin e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, për shkak të pamundësisë së Bashkisë për të mbuluar të gjithë vlerën financiare, për shkak të mungesës së fondeve nga ana e bashkisë.

5. Ndihma financiare për familjen e shtetasit Fatmir Peraj, përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329,datë 16.05.2012.

6. Ndihma financiare që do të akordohet do të përdoret për t'i ardhur në ndihmë familjes së shtetasit **Fatmir Peraj**, objekti shtëpi banimi e të cilit është dëmtuar nga mot i keq i rene ne banesen e ketij shtetasi.

7. Dëmtime nga ana ndërtimore në vlerën 250.468 (dyqind e pesdhjete mije e katerqind e gjashtedhete e tete) leke.

Vlera në total e dëmeve është : 250,468 (dyqind e pesdhjete mije e katerqind e gjashtedhete e tete) leke.

8.Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55/6 të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore".

9.U miratua më datë 30/04/2020.

10.U shpall me datë 08/05/2020.

SEKRETAR I KESHILLIT

Emirjan Hasmujaj



KRYETARI I KESHILLIT

Ilir Halaj